Kronikë

E rëndë në Gramsh/ Kishin dinamit në kroskot, makina shpërthen në ecje! Plagosen dy vëllezër (EMRAT)

Nuk ka shpërthyer tritol në makinën me të cilën po udhëtonin dy vëllezërit Mina pasditen e së dielës në qytetin e Gramshit. Shqiptarja.com mëson detaje të reja nga hetimi. Dy vëllezërit po marrin mjekim në spitalin e Traumës

- Zbardhet ngjarja në Gramsh/ Shpërthimi nuk ishte tritol! Vëllezërit mbanin në kroskot dinamit për të gjuajtur peshk
- Report Tv siguron fotot e dy vëllezerve të mbetur të plagosur pas shpërthimit në makinën e tyre në Gramsh
- VIDEOLAJM/ Momenti kur një prej vëllezërve Mina transportohet me helikopter drejt Traumës
- FOTOLAJM/ Pasojat e shpërthimit në Gramsh, u thyen xhamat e banesave dhe makinave përreth

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

GetButton

Redaksia
21 Korrik, 17:37 | **Përditesimi: 22 Korrik, 00:19**

Share

Gramsh – Një makinë tip Ford Focus ka shpërthyer teksa ishte në lëvizje pasditen e sotme (21 korrik 2024) për pasojë janë plagosur rëndë dy vëllezër, Algert dhe Eraldi Mina të cilët ndodheshin në mjet.

Ngjarja e rëndë është regjistruar rreth orës 17:20 në lagjen "Xhile Liçi", në unazën e Gramshit. Burime për Shqiptarja.com dhe Report Tv sqaruan se shpërthimi ishte shkaktuar prej dinamitit që vëllezërit e mbanin brenda në makinë, dyshohet për të gjuajtur peshk.

Edhe policia përmes një njoftimi të shpërndarë më vonë konfirmoi këtë tezë duke hedhur poshtë dyshimet e para se kishim të bënim ngjarje kriminale, lëndë tritoli të vendosur në makinën e vëllezërve për ti eliminuar ata. Gjithashtu saktësoi dhe llojin e lëndës plasëse. Amonit Malor.

LEXO EDHE:
Shpërthimi me tritol në derën e motrave Nikolli në Elbasan, çështja i kalon SPAK, do hetohet me dosjen e Nuredin Dumanit

> *"Në përfundim të veprimeve të para, rezultoi se nuk ka pasur shpërthim nga jashtë të automjetit (pra nuk kemi të bëjmë me lëndë eksplozive) por dyshohet se drejtuesi i automjetit ka pasur në kroskotin e automjetit lëndë plasëse të dyshuar Amonit Malor, me fuqi të ulët veprimi, lëndë e cila dyshohet se ka shpërthyer për shkak të nxehtësisë" thuhet në njoftimin e mëvonshëm të policisë së Elbasanit.*

Në momentin e shpërthimit të makinës me targa "AB 713JT" në timon ka qenë Algerti, ndërsa Eraldi ka qenë pasagjer. Ky i fundit ka marrë edhe plagët më të rënda, pasi ka qenë më afër kroskotit dhe dëmtimet më të mëdha i ka në gjymtyrë.

Shpërthimi ka qenë aq i fuqishëm sa dëmtoi edhe xhamat e banesave përreth por dhe makinave që ndodheshin të parkuara aty.

Hetimet
Një grup i posaçëm hetimor dhe njësia antieksploziv e Repartit Special Renea, shkuan në vendngjarje për të kryer ekzaminime të mekanizmit e rrethaneve qe kishin ndikuar në shpërthimin e ndodhur në automjet.

Shpërthimi i fuqishëm sipas ekspertëve ka ndodhur nga brenda jashtë makinës dhe jo e kundërta. Nëse do të ndodhte kjo e fundit do të kishim të bënim me një ngjarje kriminale.

Vëllezërit merren me biznes, njëri zotëron një lokal dhe tjetri një mobilieri dhe nuk figuronin persona me precedentë penalë.

> *'Rreth orës 17:20, në lagjen "Xhile Liçi", Gramsh, automjeti tip "Ford Focus", që drejtohej nga shtetasi A. M., gjatë kohës që automjeti ka qenë në lëvizje, në rrethana ende të pa qarta ka shpërthyer.*
> *Si pasojë është dëmtuar shtetasi A. M. dhe pasagjeri shtetasi E. M. (vëllezër), të cilët janë transportuar për ndihmë mjekësore në spital.'. njofton policia.*

Pasi morën mjekimin e parë në spitalin e Elbasanit, të dy vëllezërit u transportuan me urgjencë në spitalin e Traumës në Tiranë.



Algert Mine dhe Erald Mine

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 21:55

Shpërthimi në Gramsh/ Policia zbulon lëndën plasëse: Ndodhi për shkak të nxehtësisë, ishte e vendosur në kroskot! Nuk ka ngjarje kriminale

Policia ka dhënë sqarime lidhur me ngjarjen e rëndë në Gramsh teksa shpërtheu makina e dy vëllezve që mbetën të plagosur. Sipas policisë dhe pas ekzaminimeve të Repartit Renea, nuk kemi të bëjmë me një ngjarje kriminale.

Lënda e shpërthyer ishte e vendosur në kroskotin e automjetit dhe bëhet fjalë për lëndën plasëse Amonit Malor, me fuqi të ulët veprimi, e cila mund të ketë shpërthyer për shkak të nxehtësisë.

> *"Për sqarimin dhe dokumentimin e këtij rasti u ngrit një grup i posaçëm hetimor dhe në vendngjarje shkoi edhe njësia antieksploziv e Repartit Special Renea, për të kryer ekzaminime të mekanizmit e rrethaneve qe kishin ndikuar në shpërthimin e ndodhur në automjet.*
>
> *Në përfundim të veprimeve të para, rezultoi se nuk ka pasur shpërthim nga jashtë të automjetit (pra nuk kemi të bëjmë me lëndë eksplozive) por dyshohet se drejtuesi i automjetit ka pasur në kroskotin e automjetit lëndë plasëse të dyshuar Amonit Malor, me fuqi të ulët veprimi, lëndë e cila dyshohet se ka shpërthyer për shkak të nxehtësisë.*
>
> *Nga tërësia e veprimeve të kryera rezulton se kemi të bëjmë me një ngjarje aksidentale dhe nuk ka asnjë indicje për veprim kriminal ndaj të dëmtuarëve."*

G.K/Shqiptarja.com

Share

Ora 21:08

Zbardhet ngjarja në Gramsh/ Shpërthimi nuk ishte tritol! Vëllezërit mbanin në kroskot dinamit për të gjuajtur peshk

Detaje të reja bëhen me dije lidhur me ngjarjen në Gramsh ku pas një shpëthimi në makinë mbetën të lënduar dy vëllezër.

Siç bën me dije gazetar i Report Tv, Sokol Dema lënda që ka shpërthyer nuk ka qenë një lëndë tritoli, pra nuk kemi të bëjmë me një ngjarje kriminale.

Por ka qenë një lëndë që ka qenë brenda në makinë, të cilët vëllezërit e kanë pasur në kroskot, dyshohet për të gjuajtur peshkë.

Ekspertët e konfirmojnë shpërthimin por ajo ka ndodhur nga brenda jashtë dhe jo nga jashtë brenda, siç janë ngjarjet kriminale.

Lënda është lëndë dinamit me fuqi të ulët. Vetëm njëri prej vëllezërve, pasagjer, ka probleme me gjymtyrët por të dy janë jashtë rrezikut për jetën.

G.K/Shqiptarja.com

Share

Ora 20:22

Shpërthimi në Gramsh/ Banorët: U duk si bombë atomike, na u dëmtua makina

Gazetari Ronald Gjoshi ka sjellë përjetimet e banorëve të Gramshit pranë vendit ku ndodhi shpërthimi e cila plagosi dy vëllezër në makinën e tyre teksa po ecnin në Unazën e qytetit. Një burrë dhe një grua që kanë shtëpinë pranë rrugës ku ndodhi ngjarja thonë se u duk si një bombë atomike shpërthimi.

> *'Plasi shpërthimi. U trembëm, filoi që tek benzi i parë filloi. Kur ndaloi këtu, plasi si bombë e madhe. Dy vëllezërit nuk i njoh, njoh familjen. Njerëz të urtë. Babai i dy fëmijëve ka qenë në uzinë. E ëma është pastruese tek shkolla. I ati në pension. Nuk i njoh për njerëz të këqij. Çunat nuk i njihja.'*

> *'Në banesë nuk ka patur, por makina është dëmtuar. U trembëm. Lajmëruam policinë, zjarrfikësin. Të atin ia njoh. Ishim brenda në shtëpi. U duk si bombë atomike. Kam 11 vjet që e kam ble makinën, por llamarina rregullohet.'*

Në fillim u mendua si shpërthim me tritol, teksa u fol për një ngjarje kriminale. Më pas rezultoi se në kroskotin e makinës vëllezërit mbanin me vete lëndë plasëse për peshkim, me shumë mundësi dinamit e cila ka shpërthyer prej nxehtësisë, teksa makina ishte në lëvizje e sipër.

G.K/Shqiptarja.com

Share

Ora 19:35

Report Tv siguron fotot e dy vëllezerve të mbetur të plagosur pas shpërthimit në makinën e tyre në Gramsh



Report Tv siguron fotot e dy vëllezerve të mbetur të plagosur rëndë pasditen e sotme pas shpërthimit me tritol në makinën e tyre në Gramsh.

Të dy janë dërguar me urgjencë tek spitali i Traumës në kryeqytet me helikopter.

G.K/Shqiptarja.com

Share

Ora 19:15

VIDEOLAJM/ Momenti kur një prej vëllezërve Mina transportohet me helikopter drejt Traumës

Report Tv siguron pamjet e momentit të transportimit të një prej vëllezërve Mina me helikopter drejt Spitalit të Traumës në Tiranë.

Vëllezërit Mina mbetën të plagosur pasditen e sotme pas një shpërthimi me tritol në makinën e tyre në qytetin e Gramshit.

G.K/Shqiptarja.com

Share

Ora 18:51

FOTOLAJM/ Pasojat e shpërthimit në Gramsh, u thyen xhamat e banesave dhe makinave përreth

Pasojat e shpërthimit sot në Gramsh, ku dyshohet se një tritol shpërtheu një makinë ku ishin dy vëllezër që janë drejt Traumës, u ndjenë edhe në zonën përreth.

Siç shihet edhe nga pamjet e siguruar nga Report Tv, shpërthimi ka qenë i fortë dhe ka dëmtuar xhama banesash dhe xhamat e makinave që kanë qenë pranë.

Ende policia po heton për shkaqet e shpërthimit.

G.K/Shqiptarja.com

Share

G.K/S.G/Shqiptarja.com

TAG: Elbasan | gramsh | algert mina | eraldi mina | shperthim

Komento

Komente

Iris: 22/07/2024 01:17

O.K,po pranojme shpjegimin e policise,por si shume jane keta qe po e pesojne per menyren si peshkojne me lende plasese,apo gjeneratore! A nuk eshte rasti te ashpersohen ligjet per gjuetine e peshkut me metoda te tilla?!

Përgjigju

Sati: 21/07/2024 23:28

Thjesht dinamit , nuk shpërthen çfardo lloi temperature të jet. Të shpërthejë duhet pa tietër kapsolla detonatere. Ti kenë të shkuara e qoft e pakt.

Përgjigju

Njoni: 21/07/2024 22:36

Keta donin te vrisnin peshkun peshku vrau keta.

Përgjigju

E verteta: 21/07/2024 21:54

Po tjetee cfare mbanin ne kroskot? 12.7mm per te vrare arinj? Po lepujt me cfare kalibri i vrasin? Nuk shperthen tritoli dhe cdo lloj eksplizivi tjeter pa kapsollen ose detonatorin, apo ja kishin vendoaur dhe po loznin rruges? Kush i nxjerr keto perralla ministri qe nuk po e kupton nga po i vijne ngjarjet? Gallate

Përgjigju

Bim: 21/07/2024 21:40

Peshqit e medhenj e te vegjel falenderojn

Përgjigju

Fadili: 21/07/2024 21:37

I ka zen gjynahu!

Përgjigju

Dori: 21/07/2024 19:48

Cfar po ndodh keshtu ne ket vend o popull.A ka polici qe parandalon kto ngjarje apo policia esht vetem per te mbledh kockat e kufomat? Esht ber policia jon si agjensi varrimesh,vec per te transportuar te vdekurit shkon

Përgjigju

Partia: 21/07/2024 21:50

Na le rehat se po shpërndajnë uje me 10 vetë që i marrin mw kamera, qesh pak se je pa menje.

E. R.: 21/07/2024 19:31

Me kete ju uroj nje fundjave te kendshme

Përgjigju

Real: 21/07/2024 18:32

Po po duket qe eshte difekt i linjes te tensionit te kanabisit. Pasojat e kanibizimit dhe suportit te trafikut te droges do zgjatin ne shqiperi shume me teper se '97.

Përgjigju

Trafiku: 21/07/2024 19:38

Ke te drejt or shok. Esht nderprer lontano e lekeve pa djerse dhe ky esht rezultati

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
'Rasti Qefalia', a fshihen gjobat pas akuzave të Këlliçit, Nokës, opozitës?

Po | Jo | Ndoshta

Lajme të tjera

Shpërthim me tritol pranë banesës së Meard Berberit në Pogradec, organizator i sulmit me armë ndaj Hotel Volorekës në 2020! I dënuar 5 herë

22 Korrik, 07:39

Vettingu 'zbraz' Prokurorinë e Elbasanit, 6 hetues nga 20! Dhoma e Avokatisë: Të merren masa

Ronaldo Gjoshi

21 Korrik, 14:41

Flukset në pikat e kalimit kufitar, drejtori i Doganave Gazheli në terren! Inspektim në Muriqan, 17 mijë qytetarë kaluan në 24 orë

20 Korrik, 17:34



Sarandë/ Shpërthen shtylla e tensionit të lartë, bizneset dhe banesat ngelin pa energji elektrike

19 Korrik, 09:24

Tirana s'ia del, Torpedo e mposht 0-1 në Elbasan dhe e eliminon nga Conference League

18 Korrik, 22:11

Moti i pazakontë, reshje të dendura shiu në Dhërmi, Himarë dhe Borsh! Stuhi edhe në Elbasan

18 Korrik, 16:33

Elbasan, i vodhi vëllait 1.5 mln lekë nga llogaria bankare, në pranga 33-vjeçari (EMRI)

18 Korrik, 13:34



Motrat Nikolli akuzuan Nuredin Dumanin se u vendosi tritol, identifikohet autori me precedentë! U fiksua nga kamerat e sigurisë

18 Korrik, 13:06

Champions League/ S'ka mrekulli në 'Elbasan Arena', Egnatia eliminohet me penallti nga Borac Banja

18 Korrik, 08:39

Stuhi e fuqishme ere dhe shiu në Elbasan

17 Korrik, 18:53

Xhovana Nikolli akuzon Nuredin Dumanin se i vuri tritol në derën e banesës: S'është burrë por ordiner

17 Korrik, 16:21

Vrau me sëpatë kunatën e tij në Elbasan, dënohet më burgim të përjetshëm Tefik Tashi

17 Korrik, 15:49

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje